



Pranuar / Dorezuar Priljena / Predatu Received / Delivered	28.08.2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednitca Org. / Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOMSHUK	5840/2023		1/4



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.995/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi -anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, duke vepruar sipas ankesës me numër A.nr.995/2023 të datës 14.07.2023 të parashtruar nga ankuesi në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 28.08.2023 njëzëri mori këtë:

V E N D I M

I. Detyrohet Njësia e Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës që kërkesën e datës 02.06.2023 lidhur me kompensimin material për punët shtesë sipas vendimit 27.12.2022 të nëpunësit ta delegoj tek organi kompetent respektivisht pranë Institutit të Mjekësisë Ligjore në kuptim të nenit 75 të Ligji Nr. 05/L -031 Për Procedurën e Përgjithshëm Administrative.

II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Me datën 22.12.2022 z. Zëvendësues i Drejtorit të Përgjithshëm në Institutin për Mjekësi Ligjore ka kërkuar mbështetje me një zyrtar nga ana e Shërbimit Korrektues të Kosovës që të jete pjesë e Komisionit të Ankesave pranë Institutit të Mjekësisë Ligjore, ndërsa me date 27.12.2022 Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës ka propozuar ankuesin Zyrtar i Personelit në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë për anëtarë të Komisionit të Ankesave në Institutin e Mjekësisë Ligjore.

Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm në Institutin për Mjekësi Ligjore, po me të njëjtën datë konkretisht me datë 27.12.2022 ka nxjerr Vendim me numër protokoll 969/IML për ndryshim dhe plotësim të vendimit me numër 47/2022 për Emërimin e Komisionit të Ankesave të Institutit për Mjekësi Ligjore, ku në dispozitiv të vendimit në pikën 1.3 ceket se Zyrtar i Personelit në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë është emëruar anëtarë i Komisionit të Ankesave në Institutin e Mjekësisë Ligjore.

Ankuesi me datën 02.06.2023 përmes emailit me kërkesë i është drejtuar Njesisë së Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës pemës të cilës i njëjti ka kërkuar që në bazë të Rregullores 10/2023 ti bëhet kompensimi për funksion shtesë sipas vendimit të datës 27.12.2022. Ndërsa kjo e fundit nuk i ka kthyer asnjë përgjigje ankuesit.

Ankuesi i pa kënaqur me heshtjen administrative të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës me datën 14.07.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 5251/2023, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, me pretendim lidhur me mosëkzekutimin e pagës deri në 20 % të pagës baze për angazhim në një institucion tjetër publik, si dhe mos ekzekutimin e pagës në mënyrë retroaktive të masës 20% për angazhimin në institucion tjetër publik nga hyrja në fuqi të Ligjit të pagave në sektorin publik.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave, me datë 21.06.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Shërbimin Korrektues të Kosovës. Ndërsa Këshilli, me datë 25.07.2023 përmes e-mailit ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosien e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokoll 5251/2023 të datës 14.07.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Emailin e datës 02.06.2023 të drejtuar , Vendimin me numër 85/2022 të datës 27.12.2022; Emailin e datës 27.12.2022 të drejtuar Emailin e datës 14.07.2023 të drejtuar KPMSHCK-së; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 21.06.2023; Përgjigjja në ankesë me numër të protokollit 995/2023 e datës 25.07.2023; Akt emërimin e datës 20.11.2014; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Zyrtar i Personelit; Emailin e datës 18.08.2023 të drejtuar lidhur me provat shtesë; Takimin e Komisionit të Ankesave të datës 29.12.2022; Takimin e Komisionit të Ankesave të datës 30./12.2022; Takimin e Komisionit të Ankesave të datës 27.01.2023; Takimin e Komisionit të ankesave të datës 23.01.2023; Takimin e komisionit të ankesave të datës 01.03.2023; Takimin e komisionit të ankesave të datës 03.03.2023; Takimin e komisionit të ankesave të datës 14.03.2023; Takimin e komisionit të ankesave të datës 22.03.2023; Takimin e komisionit të ankesave të datës 21.03.2023; Takimin e komisionit të ankesave të datës 18.01.2023; Takimin e komisionit të ankesave të datës 19.01.2023; Takimin e Komisionit të Ankesave të datës 04.04.2023; Emailin e datës 05.04.2023 të drejtuar , Emailin e datës 02.06.2023 të drejtuar ; Vendimin me numër 85/2022 të datës 27.12.2022;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosien e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë konstatoi se janë plotësuar kushtet ligjore që të detyrohet organi administrativ kompetent gjegjësisht Njësia e Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues

të Kosovës që kërkesën e datës 02.06.2023 lidhur me kompensimin material për punët shtesë sipas vendimit 27.12.2022 të nëpunësit ta delegoj tek organi kompetent, *sepse*

Nga provat e administruara të lëndës rrjedhë së ankuesi është i punësuar sipas Akt emërimit të datës 20.11.2014 ne Shërbimin Korrektues të Kosovës në pozitën e punës "Zyrtar i Personelit" në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë, ku sipas Vendimit me numër protokollit 969/IML të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm në Institutin e Mjekësisë Ligjore, për ndryshim dhe plotësim të vendimit me numër 47/2022 për Emërimin e Komisionit të Ankesave të Institutit për Mjekësi Ligjore me propozim të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës është emëruar anëtarë i Komisionit të Ankesave në Institutin e Mjekësisë Ligjore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka analizuar nenin 38 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik i cili ka përcaktuar se ; 1. Kur zyrtaret/ët publik, sipas legjislacionit në fuqi emërohen/caktohen që të shërbejnë në një bord, komision profesional apo organ tjetër publik që kërkon ekspertizë profesionale dhe përbën funksion shtesë për zyrtaren/in, ky/kjo zyrtar/e publik/e ka të drejtën e kompensimit shtesë për këtë funksion. 2. Kompensimi sipas pikës 1. të këtij neni nuk nënkupton detyrat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga pozita të cilën e mban zyrtarja/i publike, përfshirë këtu edhe pjesëmarrjen në komisione dhe/apo organe të tjera të themeluara brenda institucionit. 3. Kompensimi sipas këtij neni bëhet në masën tridhjetë për qind (30%) për kryetaren/in dhe njëzet për qind (20%) për anëtarët/ët, të pagës bazë së zyrtares/it kryesor administrativ të institucionit në të cilën themelohet bordi, komisioni profesional apo organi tjetër publik. 4. Kompensimi i parashikuar në këtë nen, në rastin kur bordi, komisioni profesional apo organi tjetër publik mbledhet së paku një (1) herë në muaj, përfitohet çdo muaj, me kusht pjesëmarrje në mbledhje. 5. Kompensimi i parashikuar në këtë nen, në rastin kur bordi, komisioni profesional apo organi tjetër publik mbledhet më rrallë se një (1) herë në muaj, kompensimi përfitohet për çdo mbledhje, me kusht pjesëmarrje në mbledhje. 6. Qeveria, me propozim të ministrisë përgjegjëse për administratë publike dhe pas pëlqimit nga ministria përgjegjëse për financa, me akt nënligjor miraton kriteret për përfitim të këtij kompensimi.

Tutje kolegji i Këshillit ju referua edhe nenit 6 Rregullores (QRK) nr. 10/2023 për Kompensimin Për Funksionin Shtesë i cili ka përcaktuar se: , *Procedura për miratim të kompensimit Institucioni që themelon Bordin apo Komisionin sipas përcaktimeve të kësaj Rregulloreje, në Vendimin e themelimit parasheh të drejtën për kompensim të anëtarëve të Bordit apo Komisionit dhe e përcjell tek Njësia përkatëse për ekzekutim.* Andaj në kuptim të këtyre dispozitave ankuesi kërkesën lidhur me kompensimin është dashur të parashtoj kërkesën tek organi ku është themeluar Bordi apo Komisioni.

Andaj bazuar në dispozitat e lartcekura po ashtu edhe bazuar në shkresat e lëndës organi i punësimit respektivisht Njësia e Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës që kërkesën e datës 02.06.2023 lidhur me kompensimin material për punët shtesë sipas vendimit 27.12.2022 të nëpunësit ta delegoj tek organi kompetent respektivisht pranë Institutit të Mjekësisë Ligjore në kuptim të nenit 75 paragrafi 1 i Ligji Nr. 05/L -031 Për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, ku është përcaktuar se „1. Kur një organ publik merr një kërkesë me shkrim që është jashtë kompetencave të veta, pa vonesë do t’ia kalojë kërkesën organit kompetent dhe do të njoftojë dërguesin për këtë”



Theksuar si me sipër, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:**

*Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**

Lënda me numër A.nr.995/2023

**Ilire Mehmeti-SHAQIRI**

*Procesmbajtëse*

**Malsore Gashi-BAJRAKTARI**

*Kryetare e Kolegjit*

**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

